

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6685
E hënë, 22 gusht 2022
çmimi 0.40

Pesë vjet pa Bajram Rexhepin

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AVOKATËT E LIDERËVE TË UÇK-SË IA DREJTOJNË DISA KËRKESA GJYQITARIT
TË PROCEDURËS PARAPRAKE NË GJYKATËN SPECIALE | FAQE 4-5

ZPS-ja NË HAGË PO BASHKËPUNON ME BEOGRADIN, SIKUR KOSOVA TË JETË PJESË E SERBISË



**EPOKA
ERE**

Avokatët e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, e kanë akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se është duke bashkëpunuar me Beogradin sikur Kosova të ishte pjesë e Serbisë. Në këtë kontekst, ata kanë kërkuar nga ZPS-ja të tregojë cilat materiale i ka marrë nga Serbia. "Ndjenjat anti-kosovare dhe

anti-UÇK mbeten një faktor i rëndësishëm dhe me ndikim në politikën kryesore serbe deri në ditët e sotme", është thënë në parashtrësën e avokatëve të liderëve të UÇK-së. Sipas avokatëve, në asnjë mënyrë materiali që është siguruar nga Serbia nuk duhet të vlerësohet njëjtë sikur materialet e tjera në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së

INCIDENTI NË GRAMSH, ARRESTOHEN DY RUSË DHE NJË UKRAINAS, DYSHIME PËR SPIUNAZH | FAQE 3



SHOIPTARËT E LUGINËS, TË DISKRIMINUAR NË SERBI, PA SHTETËSI NË KOSOVË | FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



RITJJA E RASTEVE ME COVID,
LATIFI PARALAJMËRON VJESHTE TË
VËSHITRË F. 6

VUÇIQI: E KAM MBËSHTETJEN E
SERBËVE NGA KOSOVA PËR NJË
KOMPROMIS F. 3

NUK ZBATOHET LIGJI PËR
KONTROLLIN E DUHANIT, SHKELET
EDHE NË INSTITUCIONET PUBLIKE F. 6

EKONOMI



TAHIRI: PAAFTËSIA E QEVERISË DHE
KEK-UT PO I KUSHTON KOSOVËS 56
MILIONË EURO HUMBJE NË MUJ F. 7

DOGANA PARANDALON 6 RASTE TË
KONTRABANDËS TË MALLRAVE
USHQIMORE F. 7

SI NDALET VJEDHJA E RRYMËS? F. 7

SPORT

BALLKANI E GJILANI FITOJNË,
PRISHTINA BARAZON NË FERIZAJ F. 9

Incidenti në Gramsh, arrestohen dy rusë dhe një ukrainas, dyshime për spiunazh

TIRANË, 21 GUSHT - Në Shqipëri dy shtetas rusë, M. Z., 24 vjeç dhe S. T., 33 vjeçe, së bashku me një shtetas ukrainas, F. T., 25 vjeç, janë arrestuar mbrëmjen e së shtunës nën dyshimet për spiunazh, pasi një prej tyre kishte hyrë në uzinën ushtarake në Gramsh, duke tentuar të bëjë fotografi. Sipas një njoftimi të Ministrisë së Mbrojtjes, roja ka vënë re lëvizje të dyshimta rreth objektit. Menjëherë ai ka njoftuar përgjegjësinë e rojeve se një person ka hyrë brenda territorit dhe ka tentuar të bëjë fotografi. Të dy ushtarakët më pas i kanë bërë thirrje të ndalojë të riut M. Z., ndërsa ky i fundit është përpjekur të largohet, por është ndaluar nga ushtarakët, pavarësisht se në këtë moment ai ka përdorur ndaj tyre një spray paralizues, duke ua hedhur në

fytyrë.

I ri rus është shoqëruar në komisariatit e Gramshit, policia ushtarake ka vërejtur edhe dy persona të tjerë, që dyshoheshin se po shoqëronin të riun rus që kishte hyrë në Uzinë. Sipas njoftimit të Ministrisë së Mbrojtjes, gruaja ruse 33-vjeçare dhe ukrainasi 25-vjeçar janë ndaluar nga policia jo shumë larg Uzinës, derisa udhëtonin me një automjet sportiv me targa të Ukrainës.

Të dy ushtarakët që bënë të mundur ndalimin e të riut që kishte hyrë në Uzinë janë transportuar me shpejtësi në një spital të kryeqytetit për shkak të problemeve me shikimin, të provokuara nga spray paralizues.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, ka kontaktuar personalisht me dy



ushtarakët, duke u shprehur atyre "mirënjohje që sakrifikuam për të mbrojtur një objekt strategjik".

Për momentin nuk dihet se cili ka qenë qëllimi i shtetasve rusë dhe ukrainas të arrestuar. Në një reagim për ngjarjen, kryeministri Edi Rama ka deklaruar se ata "dyshohen

për spiunazh", duke folur për "një ngjarje delikate".

Lidhur me këtë incident kanë reaguar edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti.

Për zbardhjen e saj janë angazhuar përfaqësues të Policisë Ushtarake dhe Agjencisë së Inteligjencës dhe

Sigurisë së Mbrojtjes dhe në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Kriminale dhe Drejtorisë së Antiterrorit në Policinë e Shtetit.

Autoritetet shqiptare i janë drejtuar zyrtarisht ambasadës ruse në Tiranë, duke kërkuar informacion dhe shpjegime për shtetasit e arrestuar në mbrëmje.

Uzina e Gramshit, e ndërtuar në vitin 1962, ka prodhuar në të kaluarën armë, fillimisht pushkë të tipit "Simonov", kalibër 7.62 mm dhe më pas kallashnikovë. Më pas ajo është përdorur për të ofruar shërbime prodhuese për industrinë e mbrojtjes me makineritë e saj të precizitet të lartë apo dhe riparime, ndërsa deri në një vit më parë është përdorur për demontimin e armëve të tepërta.

Zelensky paralajmëron për veprime mizore të Rosisë në ditën e pavarësisë të Ukrainës



KIEV, 21 GUSHT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka paralajmëruar të dielën se Rusia mund të bëjë diçka "mizore" gjatë ditëve në vijim pasi Ukraina feston 31-vjetorin e pavarësisë. "Rusia mund të përpiqet të bëjë diçka veçanërisht të neveritshme, veçanërisht mizore. Një nga objektivat kryesore të armikut është të na poshtërojë dhe të mbjellë dëshpërim, frikë dhe konflikt, por ne duhet të jemi mjaft të fortë për t'i rezistuar çdo provokimi dhe t'i bëjmë

pushtuesit të paguajnë për terrorin e tyre", ka thënë ai.

Dita e Pavarësisë së Ukrainës të mërkurën, më 24 gusht, shënon edhe gjashtë muaj që nga nisja e pushtimit rus të ish-republikës sovjetike. Ka zëra se në përvjetorin e pavarësisë së Ukrainës rusët do t'i nxjerrin para gjyqit luftëtarët ukrainas të kapur gjatë rrethimit të Mariupolit. Në qytetin verilindor të Harkivit, guvernatori i qytetit ka shpallur një shtetërehim nga mbrëmja e 23 gushtit deri në mëngjesin e 25 gushtit. "Ne

nuk do të lejojmë asnjë provokim nga armiku. Jini sa më vigjilentë gjatë festës sonë të pavarësisë", ka shkruar Oleg Synegubov në llogarinë e vet në "Telegram".

Harkivi ka qenë nën bombardimet e vazhdueshme ruse për javë të tëra dhe të dielën shërbimet e urgjencës thanë se dy civilë të tjerë u vranë në sulmet gjatë natës. Katër civilë janë raportuar të vrarë nga zjarri rus në Donjeck, ka thënë guvernatori i rajonit Pavlo Kyrylenko.

Nisin hetimet mbi dy aksidentet rrugore që shkaktuan 35 viktima në Turqi

ANKARA, 21 GUSHT - Autoritetet turke kanë nisur hetimet të dielën mbi dy aksidente rrugore në vendet e emergjencës ku mbetën të vrarë të paktën 35 persona. Në të dyja rastet, ndër viktimat ishin punonjës të emergjencës dhe ndihmës së parë që po tentonin t'u vinin në ndihmë personave të përfshirë në dy aksidente të mëparshme.

Trageditë e së shtunës kanë ndodhur vetëm 250 kilometra larg njëra-tjetrës në jug të Turqisë. E para ka ndodhur në autostradën midis Gaziantepit dhe Nizipit kur një autobus pasagjerësh është përplasur me ekipet e emergjencës që i

ishin përgjigjur një aksidenti në provincën Mardin në perëndim të Derikut.

Tre zjarrfikës, dy ndihmësmjekë dhe dy gazetarë, ishin në mesin e 15 personave që humbën jetën sipas ministrit të Brendshëm turk Sulejman Soyly, tetë nga viktimat ishin nga autobusi.

Agjencia e lajmeve "Ilhas" ka thënë se dy nga gazetarët e saj janë vrarë pasi ndaluan për të ofruar ndihmë për njerëzit e përfshirë në aksidentin fillestar, në të cilin një makinë ka dalë nga autostrada dhe ka rrëshqitur nga një argjinaturë.

Pamjet televizive kanë treguar një ambulancë me



dëmtime të rënda në pjesën e pasme dhe autobusin i cili është kthyer nga ana e tij përgjatë autostradës. Guvernatori i Gaziantepit, Davut Gul, ka thënë se 22

persona janë plagosur në përplasjen e dytë.

Ngjarja tjetër ka ndodhur pasditen e së shtunës në Derik pasi një kamioni mallrash i ka dështuar

sistemi i frenimit, duke u përplasur me dy automjete të tjera pranë një karburanti. Ndërsa punonjësit e emergjencës po punonin në vendngjarje dhe turmat janë mbledhur për të parë, një kamion tjetër ka humbur kontrollin dhe është futur mes tyre. Duke folur nga vendngjarja, Soyly ka thënë se 20 persona janë vrarë dhe 26 të tjerë janë plagosur. Një oficer policie ishte në mesin e viktimave dhe dy shoferë janë arrestuar pas nisjes së hetimit, tha ai. Turqia ka një rekord negativ të sigurisë rrugore. Rreth 5 362 kanë vdekur në incidente trafiku vitin e kaluar, sipas autoriteteve.

Shqiptarët e Luginës, të diskriminuar në Serbi, pa shtetësi në Kosovë

PRISHTINË, 21 GUSHT - Serbia ka vazhduar diskriminimin duke pasivizuar adresat e më shumë se katër mijë shqiptarëve nga Presheva, Medvegja e Bujanoci e ata që jetojnë tash e disa vjet në Kosovë kanë vështirësi të mëdha për ta marrë shtetësinë e Kosovës.

Derisa një ligj për pajisjen e shtetësisë së Kosovës pritet të hartohet dhe në fund të vitit të dërgohet në Kuvend për votim, shqiptarët e Luginës së Preshevës jetojnë me vite të tëra pa fituar të drejtën e shtetësisë së Kosovës.

Fikri Mehmeti nga malësia e Bujanocit që nga viti 1999 jeton në Gjilan, por pa dokumente të Kosovës. "Që nga viti 1999 ne jetojmë në Republikën e Kosovës si qytetarë arpatrit, pa asnjë lloj dokumenti identifikimi... Të mos kesh as një leje qëndrimi të përhershme ose letërnjoftim të Kosovës është më shumë se e paimagjinueshme", ka thënë ai.

Ai ka thënë se për leje qëndrimi në Kosovë i duhet një dokument identifikimi nga vendi i origjinës. "Për të marrë leje qëndrim të Kosovës duhet të kemi dokument identifikimi valid prej vendit të origjinës. Kjo është normale të vërehet për një qytetar i cili vjen në rrethana normale në Republikë të Kosovës dhe kërkon leje qëndrimi, mirëpo ne të cilët kemi ardhur në gjendje lufte, unë i kam pasur atëherë 6 vjet, nuk kam pasur asnjë lloj dokumenti të Serbisë dhe mua më kërkojnë patjetër që ta kem një letërnjoftim apo pasaportë serbe me afat normal në mënyrë që të marr leje qëndrimi, dhe tani ka një vit që janë krijuar disa lehtësime të tjera, kinse që e kanë zëvendësuar këtë dokument me dokumente të tjera, mirëpo prapë nuk janë duke i interpretuar profesionalisht, prapë kur të shkoj të aplikoj për leje të qëndrimit, has në vështirësi thuajse të njëjta siç kam hasur më herët", ka theksuar ai.

Më tutje, Mehmeti ka thënë se për leje të qëndrimi janë të detyruar të nxjerrin dhjetëra

dokumente, derisa i kritikon edhe zyrtarët që interpretojnë ligjin. "Do të thotë, një leje të qëndrimit në Kosovë ne jemi detyruar ta nxjerrim me dhjetëra herë, kështu mos të them me qindra dokumente dhe ende nuk na është mundësuar ta marrim ashtu siç e parashih ligji. Disa kategori e kanë për bashkim familjar tri vjet, disa kategori për punësim pesë vjet. Neve një vit na lejohet, një vit refuzohet. Ka raste që dikush ka tetë vite rend dhe prapë i thonë ti duhet të presësh 10 vjet, do të thotë bëjnë interpretime të ligjit personat që nuk janë kompetentë të zyrës për të huaj brenda dikasterit përkatës", ka theksuar Mehmeti.

Në vitin 2001 një pjesë e shqiptarëve të jugut të Serbisë kanë marrë shtetësinë e Kosovës përmes UNMIK-ut. Një ndër ta është edhe Fjolla Ibishi, e cila ka thënë se shtetësinë e ka përdorur për punësim. "Në vitin 2001 nuk ka pasur Ministri të Brendshme, dokumentet i kam marrë përmes UNMIK-ut, mirëpo shtetasin e Republikës së Kosovës e kam shfrytëzuar për punësim, ndërsa për regjistrim të studimeve jam regjistruar me dokumente të Serbisë", ka thënë ajo.

Ndërsa Enver Haziri nga shoqëria civile për të drejtat e shqiptarëve të dëbuar nga Kosova Lindore në Gjilan ka thënë se problematika ka filluar që nga viti 1999. "Problematika ka filluar qysh në vitin 1999. Problematika me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve, ku forcat serbe me dhunë dëbojnë 5 mijë qytetarë nga malësia e Bujanocit, Karadaku i Preshevës dhe një pjesë e madhe e Medvegjës dhe aty, me të ardhur në Gjilan, fillon avazi, të cilit nuk po i shihet drita sa i përket çështjes me shtetësi të Republikë së Kosovës", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se është mision i Serbisë dhe i politikës serbe që t'i diskriminojnë shqiptarët. "Kur shteti serb na diskriminon, ne nuk çuditemi sepse është mision i Serbisë dhe i politikës serbe t'i



diskriminojnë shqiptarët, por kur neglizhon shteti ynë, shteti amë, Republika e Kosovës, me këta qytetarë, me të vërtetë është e dhimbshme sepse, përpos vështirësive që ua krijon në jetën e përditshme, i dëmton jashtëzakonisht edhe në aspektin moral", ka thënë ai. Sipas tij, ligjet janë marrë nga Bashkimi Evropian dhe në letër janë të mira për t'i parë, por në praktikë nuk përkojnë me realitetin. "Unë jam jurist me profesion. Unë i di ligjet, mirëpo ligjet janë marrë 'copy paste' nga Bashkimi Evropian dhe në letër janë të mira me i pa, por nuk përkojnë me realitetin. Shoqëria e Kosovës ka specifika të tjera, andaj unë konsideroj dhe e lus Qeverinë e Republikës së Kosovës të bëjë plotësim-ndryshimin e ligjeve", ka thënë ai.

Kurse Ragmi Mustafi nga Këshilli Kombëtar Shqiptar në Bujanoc ka thënë se çështja e pasivizimit të adresave është veprim diskriminues që tash po e bëjnë institucionet e Serbisë. Sipas tij, nuk ka numër zyrtarë të personave të pasivizuar, pasi Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë nuk i është përgjigjur kërkesës për të treguar këtë numër.

Mustafi ka thënë se çështja e pasivizimit të adresave është shumë e ndjeshme. "Çështja e pasivizimit është një çështje shumë e ndjeshme dhe ne po shpresojmë që përfundimisht të marrë formë me raportin e Parlamentit Evropian, me raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit që kanë theksuar në drejtim të

komunitetit shqiptar, pra në narcizëm, gjuhë të urrejtjes e madje me pasivizimin e adresave që janë të pavlerësuar dhe diskriminuese", ka thënë ai. Ai ka thënë se bashkë me selitë e Këshillit Kombëtar Shqiptar janë duke u marrë me listën e të larguarve nga shtetësia e Serbisë. "Po ne bashkërisht me selinë e Këshillit Kombëtar në Bujanoc dhe degën në Preshevë, në përkrahim për çështjen që ka të bëjë me pasivizimin e adresave, kemi një listë që janë lajmëruar dhe përkatësisht janë një numër i madh që nuk janë të vetëdijshëm që janë pasivizuar, dhe pasivizim e adresave e kërkojnë në momentin kur i rregullojnë dokumentet", ka thënë ai.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme në Kosovë (MPB) kanë theksuar se ligji për fitimin e shtetësisë është në fazën e hartimit, e ai do të dërgohet në përputhje me afatet ligjore. "Ligji për shtetësi është në fazën e hartimit. Të gjitha çështjet që janë adresuar në koncept-dokument do të përfshihen në këtë ligj, dhe ky ligj do të dërgohet në përputhje me afatet ligjore (afati i fundit është 30.11.2022 dhe ne synojmë para kësaj date) të përcaktuara me planin e akteve ligjore të miratuara nga qeveria", është thënë në njoftimin e MPB-së.

Për dokumente në rast të aplikimit vlen një certifikatë e vlefshme udhëtimi me afat të vlefshmërisë të paktën 3 muaj më të gjatë se periudha e lejeqëndrimit të kërkuar, certifikata e martesës, ose certifikata e bashkësisë familjare

apo certifikata e lindjes së fëmijëve, e cila vlen për ribashkim familjar, në rastet e adoptimit dëshmi për themelimin e adoptimit apo në rastet e vënies nën kujdestari, dëshmi për themelimin e kujdestarisë.

Për kategoritë e arsimimit, personave të shkollimit parauniversitar u duhet një dëshmi mbi regjistrimin në ndonjë institucion arsimor në Republikën e Kosovës e për shkollimin universitar vlen dëshmia e nivelit të lartë. Në rastin e aplikimit me kontratë të punës u duhet një kontratë e punës sipas legjislacionit në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, duhet një dokument identifikimi nga shtetasi i Republikës së Kosovës apo sponsori, mjete të mjaftueshme për jetesë të cilat dëshmojnë përmes pasqyrës bankare, kontratës së punës apo dëshmi tjetër me të cilën dëshmohet se i huaji ka mjete të mjaftueshme për jetesë, dëshminë për banimin e siguruar (dëshminë e pronësisë apo kontratën e noterizuar të qirasë), me hapësirën e nevojshme për jetesë sipas normave minimale të banimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, dëshminë që nuk është i dënuar, dhe dëshminë që nuk është nën hetime e lëshuar nga shteti, shtetas i të cilit është i huaji apo nga shteti i vendbanimit të fundit, e përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sigurimin shëndetësor, të mos ketë ndalesë hyrje në Republikën e Kosovës, dëshminë për vaksinim në rastet kur i huaji vjen nga shtetet që është shpallur gjendje epidemie.

Për shkollimin universitar në rast të aplikimit për lejeqëndrim i duhet dëshmia përmes llogarisë bankare me vlerë 500 euro.

Personat që marrin leje qëndrimi kanë vlefshmëri një vit, më pas për të vazhduar duhet të paguajnë 50 euro, ndërsa vetëm për studentët nëse marrin lejeqëndrimin i përcaktuar për 1 vit ajo ka vlefshmëri 6 muaj. /KosovaPress/

Vuçiqi: E kam mbështetjen e serbëve nga Kosova për një kompromis

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas takimit në Beograd me përfaqësuesit e serbëve nga Kosova, ka thënë se ka marrë leje prej tyre të punojë për të gjetur një zgjidhje kompromisi lidhur me vendimet e Kosovës për targarat dhe dokumentet serbe.

I pyetur se cila do të ishte një zgjidhje e tillë, ai ka thënë se "nuk e di". "Sapo ta kuptoj, do t'ju njoftoj. Ne do të përpiqemi, do të bëjmë më të mirën. Nëse mundemi, mundemi; nëse nuk

mundemi, nuk mundemi", ka thënë ai, duke shtuar se Serbia dëshiron ta ruajë paqen. Sipas tij, ajo që kanë kërkuar përfaqësuesit e serbëve nga Kosova, gjatë takimit të së dielës, ishte që të mos përballëshin me përndjekje dhe Vuçiqi ka thënë se u ka garantuar se nuk do të lejojë një gjë të tillë.

Presidenti serb ka thënë se Serbia gjendet në një situatë shumë të vështirë dhe se "do të kërkojmë me dëshpërim një



kompromis për 10 ditët e ardhshme. Shpresoj se do t'ia

dalim".

Ai i është referuar 1 shtatorit kur Kosova ka thënë se do ta rinisë zbatimin e dy vendimeve për targarat dhe dokumentet serbe, që rritën tensionet në veri të Kosovës në fund të korrikut dhe fillim të gushtit. "A besojmë në këtë, kam frikë se edhe nëse do të jetë e suksesshme, na pret kurba tjetër, shumë shpejt, dhe pastaj ajo e radhës, dhe kam frikë se rubikoni është kapërcyer prej kohësh", ka thënë

Vuçiqi.

Vuçiqi ka thënë se Kosova në raundin e fundit të dialogut në Bruksel më 18 gusht, që ka përfunduar pa asnjë marrëveshje, kishte shkuar për të diskutuar për një marrëveshje të përgjithshme për normalizimin e raporteve me gjashtë pika. Sipas tij, këto pika përfshinin njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare.



AVOKATËT E LIDERËVE TË UÇK-SË IA DREJTOJNË DISA KËRKESA GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE NË GJYKATËN SPECIALE

ZPS-ja në Hagë po bashkëpunon me Beogradin, sikur Kosova të jetë pjesë e Serbisë

Avokatët e liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, e kanë akuzuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se është duke bashkëpunuar me Beogradin sikur Kosova të ishte pjesë e Serbisë. Në këtë kontekst, ata kanë kërkuar nga ZPS-ja të tregojë cilat materiale i ka marrë nga Serbia. “Ndjenjat anti-kosovare dhe anti-UÇK mbeten një faktor i rëndësishëm dhe me ndikim në politikën kryesore serbe deri në ditët e sotme”, është thënë në parashtrësën e avokatëve të liderëve të UÇK-së. Sipas avokatëve, në asnjë mënyrë materiali që është siguruar nga Serbia nuk duhet të vlerësohet njëjtë sikur materialet e tjera në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së

EPOKA E RE

Lirim GECI

HAGË, 21 GUSHT - Katër avokatët e drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) që gjenden në paraburgim në Gjykata Speciale kanë shfaqur dilema serioze në bashkëpunimin që e ka Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) me Beogradin zyrtar.

Mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është bërë bashkë dhe është duke kërkuar nga ZPS-ja t'i tregojë cilat

materiale i ka marrë nga Serbia. Madje avokatët e liderëve të UÇK-së janë duke pretenduar se ZPS-ja në Hagë është duke bashkëpunuar me Beogradin zyrtar, nën parimin se Kosova është pjesë e Serbisë.

Në një përgjigje ndaj ZPS-së që e kanë dërguar te gjyqtari, avokatët e katër udhëheqësve të UÇK-së kanë vlerësuar se kjo e cenon rëndë procesin ndaj klientëve të tyre. Ata kanë bërë me dije se janë mbi 1 300 materiale të cilave nuk u dihet vendi i origjinës. “Përveç kësaj, prokuroria keqinterpretat në

mënyrë të rëndë parashtrësas e mbrojtjes, të cilat qartazi nuk kanë të bëjnë me ndonjë shkelje të ligjit serb. Në vend të kësaj, Mbrojtja thekson shkeljen e ligjit të Kosovës dhe rrezikon që bashkëpunimi prokurori - Serbi të bëhet me supozimin e papranueshëm dhe të paligjshëm se Kosova është pjesë e Serbisë. Thelbi i pozicionit të Prokuroria e Specializuar është se besueshmëria e informacionit që buron nga Serbia nuk është e ndryshme nga ajo e çdo ofruesi tjetër të informacionit. Kjo

tentativë për ta shpërfillur kontekstin politik në të cilin po gjykohet kjo çështje rrezikon shumë integritetin e procedurës. Ndjenjat anti-kosovare dhe anti-UÇK mbeten një faktor i rëndësishëm dhe me ndikim në politikën kryesore serbe deri në ditët e sotme”, është thënë në parashtrësën e avokatëve të liderëve të UÇK-së.

Sipas avokatëve, në asnjë mënyrë materiali që është siguruar nga Serbia nuk duhet të vlerësohet njëjtë sikur materialet e tjera në këtë procedurë.

Më tutje, sipas parashtrësës së avokatëve të liderëve të UÇK-së, ZPS-ja e Hagës ka siguruar mbi 13 mijë materiale nga Tribunali për Krime Luftë në ish-Jugosllavi, 10 mijë e 500 nga EULEX-i dhe 8 mijë materiale nga Prokuroria Speciale e Kosovës.

Avokatët e Thaçit, Veselit, Krasniqit e Selimit kanë përmendur raste nga e kaluara në Tribunalin e Hagës, ku është

tentuar manipulimi me dëshmitarë. “Parë në këtë këndvështrim, pozicioni i Prokurorisë së Specializuar është qartësisht në kundërshtim me përkufizimin e Rregullës 103 dhe do të kishte pasoja të rëndësishme për procedurat ardhshme. Jo të gjithë ofruesit e informacionit ose informacionit janë të barabartë, dhe materiali që vjen nga Serbia për të mbështetur një gjyq kundër udhëheqjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet të klasifikohet si rregull 103. Përveç kësaj, si me çdo traktat modern, marrëveshjet e tilla ndërkombëtare duhet të bëhen publike. Bazuar në konsideratat e mësipërme, rezulton se çdo marrëveshje në lidhje me bashkëpunimin në çështjet penale me shtetet ose organizatat ndërkombëtare (dhe veçanërisht me Serbinë) i nënshtrohet ratifikimit nga Kuvendi dhe duhet të jetë i disponueshëm në faqen e internetit të KSK-së”, është thënë në parashtrësën e

Specialja kthehet nga pushimi, aktgjykimi ndaj Salih Mustafës në fundvit

HAGË, 21 GUSHT - Pushimet e verës ka më shumë se dhjetë ditë që i kanë përfunduar. Kështu, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë nisur përgatitjet për shumë punë, të cilat i presin për pjesën e mbetur të vitit. Rasti i parë të cilin do ta vazhdojnë ta trajtojnë është ai i Salih Mustafës. Medina Kadriu nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka treguar se këtë vit shkalla e parë do ta japë aktgjykimin në këtë rast. "E kemi rastin e Salih Mustafës, ku është planifikuar që nga 13 deri më 15 shtator palët t'i paraqesin fjalët e tyre përfundimtare, ku pas kësaj do të përmbillet gjykimi dhe trupi gjyqës do të tërhiqet që të vendosë lidhur me fajësinë apo pafajësinë e zotëri Mustafa. Afati për vendosje është brenda 90 ditësh nga përfundimi i

gjykimin, kështu që mund të presim që brenda këtij viti ta kemi aktgjykimin e parë në shkallë të parë sa i përket një rasti për krime lufte" ka thënë Kadriu.

Përveç Mustafës, në fundvit një vendim do të merret edhe për dy krerët e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Apeli do të vendosë për rastin e tyre. "Duke i marrë parasysh të gjitha afatet që respektohen, apelimi, përgjigjet e palëve, kundërpërgjigjet e të tjera, diku gjatë dimrit mund ta kemi edhe vendimin e shkallës së dytë. Ky rast ose mund të bëhet i plotfuqishëm ose mund të ketë ndonjë ndryshim në vendim", ka thënë Amer Alija nga Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili nuk pret që këtë vit të fillojë gjykimi ndaj



ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. "Nëse gjyqtari i procedurës paraprake e vlerëson se palët janë të gatshme që të fillojë gjykimi dhe nëse nuk kërkojnë afate

shtesë për përgatitje të shqyrtimit kryesor, atëherë mund të fillojë gjykimi ndoshta në fillim të vitit të ardhshëm", ka thënë Alija. Dhomat e Specializuara prej kur nisën gjykimet në shtator të

vitit të kaluar kanë shpallur vetëm një aktgjykim në shkallë të parë, madje ai aktgjykim nuk ka të bëjë me krime lufte për çka është themeluar Specialja, por për pengim në administrimin e drejtësisë.

Pesë vjet pa Bajram Rexhepin

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Të dielën janë bërë pesë vjet qëkur është ndarë nga jeta ish-kryeministri i parë i Kosovës në kohën e pasluftës, Bajram Rexhepi. Në këtë përvjetor, Rexhepi është përkujtuar nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Ai ka thënë se për gjeneratën e re të aktivistëve e të politikanëve, Bajram Rexhepi ishte modeli i politikanit që gjithë përgatitjen e tij profesionale e personale e kishte vënë në shërbim të atdheut. "Doktor Bajrami, si mjek atdhetar që ishte afër ushtarëve të plagosur të UÇK-së gjatë luftës, politikan i respektuar që udhëhoqi Kosovën në një periudhë sfiduese të pasluftës, një personalitet unik që shtroi rrugën e dialogut dhe bashkëpunimit ndërpartiak, mbi të gjitha, lider i përgjegjshëm e parimor, ishte shembull për t'u



ndjekur", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Në prill të vitit 2017 ish-kryeministri Rexhepi ishte shtruar në QKUK për shkak të një sulmi shëndetësor në organet vitale, ndërsa më pas është dërguar në Turqi për shërim

jashtë vendit. Pas një beteje prej pesë muajsh me sëmundjen, Rexhepi kishte ndërruar jetë më 21 gusht 2017, duke lënë pas vetes bashkëshorten dhe vajzën. Bajram Rexhepi ka lindur në Mitrovicë më 3 qershor 1954. Studimet pasuniversitare i ka

kryer në Zagreb në vitin 1985. Ai kishte punuar kirurg i përgjithshëm dhe specialist endoskopik në spitalin rajonal të Mitrovicës deri në vitin 1990. Rexhepi e kaloi shumicën e karrierës së tij si kirurg dhe fitoi famë si kirurgu më i mirë në

rajonin e Mitrovicës.

Gjatë luftës së Kosovës më 1999, Rexhepi ishte bashkuar me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe tre muaj kishte shërbyer mjek në terren. Ai kishte shërbyer edhe si kryetar i Mitrovicës jugore, duke punuar me paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s për t'i zvogëluar trazirat civile.

Më 4 mars 2002, pas tre muaj bisedimesh dhe me ndërmjetësimin e shefit të atëhershëm të UNMIK-ut, Michael Steiner, Kuvendi i Kosovës e kishte zgjedhur Bajram Rexhepin kryeministër të parë të Kosovës të pasluftës.

Më 1 prill 2010 Rexhepi ishte emëruar ministër i Punëve të Brendshme. Vitet e fundit të jetës ishte tërhequr krejtësisht nga politika duke iu përkushtuar profesionit të kirurgut.

avokatëve të liderëve të UÇK-së. Në fund, mbrojtja ka kërkuar që kjo parashtrësë e tyre të merret parasysh nga gjyqtari i procedurës paraprake.

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së në Gjykatën Speciale në muajin korrik është bërë bashkë dhe ka drejtuar një parashtrim, ku ka kërkuar që gjyqtari ta obligojë ZPS-në të tregojë cilat materiale i ka marrë nga Serbia. Ndaj kësaj kërkesë është përgjigjur ZPS-ja me arsyetimin se ato materiale janë të njëjta sikur të gjitha të tjerat. Andaj, sipas tyre, nuk ka nevojë të dihet prejardhja.

Në kërkesën me shkrim të parashtruar nga avokatët e Thaçit, të Veselit, të Selimit dhe të Krasniqit, e cila ishte publikuar në faqen e Dhomave të Specializuara, është thënë se Serbia mbetet e angazhuar në

një fushatë të vazhdueshme dezinformimi kundër Kosovës dhe UÇK-së me qëllim të destabilizimit të shtetit.

"Në një gamë të gjerë vendesh të lidhura me konfliktin e viteve 1998-1999, Serbia ka përdorur vazhdimisht mjete mashtruese për ta inkriminuar UÇK-në, për ta minuar pavarësinë e Kosovës dhe për ta shmangur përgjegjësinë për krimet e veta. Në veçanti, ajo ka kryer operacione të rreme, ka manipuluar skenat e krimit dhe ka siguruar dëshmi të rreme nëpërmjet torturës dhe detyrimit, duke ngritur shqetësime të bazuara në lidhje me besueshmërinë e informacionit që buron nga ky burim", është thënë në shkresën e ekipeve mbrojtëse të liderëve të UÇK-së.

Avokatët e të akuzuarve në

Hagë kanë pohuar se Task Forca Speciale Hetimore, e më pas Zyra e Prokurorit të Specializuar, kanë marrë një sasi të panjohur, por të konsiderueshme të provave përmes marrëdhënieve të tyre bashkëpunuese me Serbinë.

Mbrojtja ka theksuar se synon të kundërshtojë prova të tilla, duke shtuar se zbulimi i ofruar për mbrojtjen deri më sot është i paplotë dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk ka treguar gatishmëri për të qenë transparente në lidhje me marrëdhëniet e saj me Serbinë dhe për t'i përmbushur kërkesat e mbrojtjes. "Në bazë të rregullit 103, mbrojtja kërkon që gjyqtari i procedurës paraprake ta urdhërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar t'ia zbulojë mbrojtjes të gjitha informacionet që ka, të cilat

fillimisht kanë ardhur nga Serbia, ose që në mënyrë të arsyeshme duket se kanë ardhur nga Serbia, si dhe prejardhjen e ndonjë materiali të tillë mbi të cilin Zyra e Prokurorit të Specializuar synon të mbështetet", është thënë në shkresë.

Po ashtu, ekipet mbrojtëse të Thaçit, të Veselit, të Selimit dhe të Krasniqit kanë kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake që ta urdhërojë ZPS-në ta zbulojë natyrën dhe shtrirjen e marrëdhënieve të Task Forcës Speciale Hetimore dhe ZPS-së me Serbinë, përfshirë bazën e saj ligjore, veçanërisht materialet e nevojshme që mbrojtja të kuptojë kushtet mbi të cilat informacioni u kërkua dhe u pranua, pasi kjo ka të ngjarë të ndikojë në kredibilitetin dhe besueshmërinë e saj. Kjo, sipas

ekipeve mbrojtëse, përfshinë të gjitha kërkesat për ndihmë dhe/ose marrëveshjet e tjera të arritura ndërmjet SITF dhe/ose ZPS-së dhe Republikës së Serbisë ose ndonjë prej organeve a institucioneve të saj, të gjitha kërkesat për informacion dhe korrespondencën shoqëruese ndërmjet SITF dhe/ose ZPS-së dhe Republikës së Serbisë ose ndonjë prej organeve a institucioneve të saj, një përmbledhje të të gjitha kontakteve në lidhje me këtë rast ndërmjet ZPS-së dhe zyrtarëve nga Republika e Serbisë ose ndonjë organi a institucioni të saj si dhe një listë të plotë të të gjitha dokumenteve dhe materialeve burimi i të cilave është Republika e Serbisë ose ndonjë organ a institucion i saj.

Rritja e rasteve me Covid, Latifi paralajmëron vjeshtë të vështirë

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Rifat Latifi, ka paralajmëruar vjeshtë të vështirë pas rritjes së numrit të rasteve me Covid-19. Ai ka theksuar se do t'i marrin masat në bazë të vlerësimit të gjendjes. Madje Latifi u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të vaksinohen. "Është shumë e mundshme që do të kemi një vjeshtë më të vështirë sesa që e kemi verën tash. Shtetet e ndryshme në Evropë kanë marrë masa më të rënda. Ne do t'i marrim ato masa që na duhet t'i marrim. Ne e kemi

krijuar një përvojë të mirë me menaxhimin e Covidit. Besoj se do t'ia dalim. Kapacitetet tona njerëzore janë më të mira. Shumica e njerëzve janë vaksinuar, por duhet prapë të vaksinohet secili prej nesh. Nëse dikush ka pasur ndonjë dilemë për vaksinim tashmë duhet të hiqet sepse ne e kemi pasur edhe një valë tjetër, ndoshta edhe ndonjë tjetër", ka thënë Latifi, duke shtuar se duhet të mësohemi për disa vjet të jetojmë me Covidin. "... na duhet të mësohemi me Covidin për disa vjet. Kështu që kapacitetet

tona janë të gatshme për ta menaxhuar Covidin, por duhet t'i shtojmë dhe përforcojmë më tepër", ka thënë Latifi për "EO". Ndërsa Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë ndërruar jetë dy persona si pasojë e infektimit me koronavirus. Sipas MSh-së, pas 942 testeve të bëra, 224 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me Covid apo 23.77 për qind e të testuarve. Aktualisht në Kosovë janë 3 191 raste aktive me Covid-19.



MASHTI dhe MSh-ja paditen nesër nga komunat, u dëmtuan mbi 35 milionë euro

PRISHTINË, 21 GUSHT - Drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka deklaruar se më 23 gusht komunat do t'i paditin Ministrinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë, pasi janë dëmtuar mbi 35 milionë euro për shkak se niveli qendror kishte nënshkruar kontratën kolektive, derisa barra financiare u ishte vënë komunave. "Më 23 gusht përfaqësuesit ligjorë dhe juridikë të komunave të Republikës së Kosovës do të deponojnë padi ndaj Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Pra, komunat janë mobilizuar dhe të gjitha së bashku të martën do ta deponojmë padinë. Në bazë



të analizave të Asociacionit të Komunave të Kosovës, vlerësohet se dëmi i cili u është shkaktuar komunave me zbatimin e kontratave kolektive, duke ua marrë mjetet financiare komunave, është mbi 35 milionë euro dhe ne kemi kërkuar dhe do të

kërkojmë përsëri që këto mjete t'u barten komunave në mënyrë që projektet kapitale, të cilat janë të parapara të zbatohen me këto mjete financiare, të gjejnë zbatim. Pra, të gjitha këto mjete financiare shkojnë drejtpërdrejt në dobi të

qytetarit. U janë marrë padrejtësisht komunave sepse kontratat janë nënshkruar nga niveli qendror, kurse barra financiare u ka rënë komunave", ka thënë ai për "Ksp". Ndërsa lidhur me investimet kapitale, Ibrahim ka thënë se mjetet e parapara tashmë janë shpenzuar. Sipas tij, shumë projekte të cilat kanë qenë të parapara të investohen në komunat e Kosovës janë ndaluar nga niveli qendror për shkak të mosfunksionalizimit të bordit të OShP-së. "Është parë që rreth 11 për qind e të gjitha mjeteve financiare në Republikën e Kosovës të parapara apo të destinuar për investime kapitale janë shpenzuar. Kjo është për

keqardhje sepse është hera parë që është duke ndodhur një gjë e tillë, se një përqindje jashtëzakonisht e vogël e investuar në Republikën e Kosovës, dhe me këtë edhe zhvillimi ekonomik lokal nuk është duke ndodhur për shkak se nuk ka investime, gjithashtu mund të themi se shumë projekte të cilat kanë qenë të parapara të investohen në komunat e Kosovës janë ndaluar nga niveli qendror për shkak të mosfunksionalizimit të bordit të OShP-së, ku janë mbi 80 apo 100 milionë euro të cilat në nivelin lokal nuk janë investuar. Po ashtu, edhe rritja e çmimeve. Kjo përqindje e ulët në investime kapitale ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në operatorët ekonomikë privatë", ka thënë Ibrahim.

Nuk zbatohet Ligji për Kontrollin e Duhanit, shkelet edhe nga institucionet publike

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ligji për Kontrollin e Duhanit vazhdon të mos respektohet dhe të shkelet. Këtë ligj nuk po e respektojnë as zyrtarët publikë që janë pjesë e institucioneve. Sipas një hulumtimi, 27 për qind e qytetarëve i ekspozohen tymit të duhanit në punë. Zyrtarët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë nuk kanë dhënë shifra se sa është numri i gjobave të shqiptuara, megjithatë nga Ministria e Shëndetësisë është bërë me dije se ka pasur raste të shkeljeve. Drejtuesi i Qendrës Kosovare për Avokim dhe Zhvillim – KADC, Shkumbin Spahiu, ka treguar se gjatë hulumtimit të vitit 2020, në tërë Kosovën, kanë vërejtur se Ligji për Kontrollin e Duhanit shkelet hapur dhe në mënyrë masive. Se ky ligj pothuajse nuk

respektohet fare e dëshmojnë edhe shifrat që kanë dalë nga ky hulumtim. "Ka dalë se rreth 81 për qind e qytetarëve i ekspozohen tymit të duhanit kur frekuentojnë baret, kafenetë apo restorantet, ndërsa përafërsisht 27 për qind janë përgjigjur se i ekspozohen tymit të duhanit në vendet e tyre të punës. Pra, kjo në mënyrë indirekte ndoshta mund të përdoret si indikator për shkak se edhe vendet e punës janë në institucione publike, se gjithsesi ka shkelje edhe në institucione publike të Ligjit për Kontrollin e Duhanit, gjegjësisht të ndalimit të pirjes së duhanit në këto hapësira", ka thënë ai. Spahiu ka thënë se ky ligj nuk po zbatohet as institucionet publike dhe zyrtarët të cilët punojnë. Zyrtari për informim në



Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, Lamir Thaçi, nuk ka treguar se sa kanë qenë shifrat e gjobave për moszbatim të këtij ligji meqë, sipas tij, disa kanë qenë për shkelje të masave anti-Covid dhe shkelje të Ligjit për

Kontrollin e Duhanit. Në një përgjigje për "Kosovapress", Ministria e Shëndetësisë ka theksuar se Ligji për Kontrollin e Duhanit, ka probleme më të theksuara në sektorin e gastronomisë, sidomos kafebaret dhe klubet e

natës. Për shqiptimin e gjobave në institucione publike, "Kosovapress" ka pritur me javë përgjigje nga kryeinspektori i Punës, Hekuran Nikçi, por ai nuk u është përgjigjur pyetjeve të dërguara në adresën zyrtare.

Si ndalohet vjedhja e rrymës?

Prishtinë, 21 gusht - Për shkak të vjedhjes së rrymës, deri në 40 konsumatorë shkyçen brenda një dite nga rrjeti i elektrik, thonë punonjës të Kompanisë për Distribucionin e Energjisë Elektrike të Kosovës (KEDS). Kohën e fundit KEDS-i ka rritur kontrollet tek ekonomitë familjare dhe komerciale, që dyshohet se shfrytëzojnë energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar.

Kontrollet po bëhen për shkak edhe të krizës energjetike që e ka mbërthyer Kosovën dhe Evropën dhe rrjedhimisht, në Kosovë janë rikthyer reduktimet e rrymës për shkak të çmimit të lartë në berëzat ndërkombëtare. Një aksion të tillë për shkyçjen e rrymës në rajone të ndryshme të Kosovës, ekipi i KEDS-it në bashkëpunim me Policinë e Kosovës e kryen edhe më 16 gusht.

Ekipi i "Radios Evropa e Lirë" ishte i pranishëm në këtë aksion.

Një biznes në komunën e Podujevës është shkyçur nga rrjeti pasi ekipi i KEDS-it konstatoi se rryma e shpenzuar nuk po faturohej. Ndaj këtij biznesi u ngrit kallëzim penal për vjedhje të rrymës.

Koordinatori për kontrollimin e humbjeve në KEDS, Fatos Çeku, ka treguar për "Radion


Evropa e Lirë" se në çfarë forme në shumicën e rasteve vidhet rryma. "Vjedhjet bëhen në forma të ndryshme si, për shembull, ka linja direkte jashtë pikës matëse me kablo të ndryshme, ndërprerës, prekje të njësorit e të tjera", ka thënë Çeku. Sipas institucioneve shtetërore, në Kosovë rreth 19 për qind e konsumit të përgjithshëm të energjisë paraqitet si humbje teknike dhe komerciale.

Humbjet teknike të energjisë elektrike janë ato që humbin në rrjetin shpërndarës, ndërkaq ato komerciale janë konsum i paautorizuar. Megjithatë, Ministria e Ekonomisë ka thënë se kostoja e vjedhjes së energjisë elektrike vitin e kaluar ka qenë 110 milionë euro, ndërkaq këtë vit parashihet që të arrijë në vlerën prej 99 milionë eurosh.

Niveli i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale të rrymës thuhet se është një ndër shkaktoresh për furnizim jo të qëndrueshëm me energji në Kosovë.

Humbjet e rrymës po e përcjellin Kosovën që nga paslufta. Ekspertët e energjisë kanë thënë se niveli i vjedhjes së rrymës ndër vite ka rënë, por mund të bie edhe më shumë.

Profesori në Fakultetin e



Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës, Bedri Dragusha, ka thënë se KEDS-i mund ta realizojë eliminimin e vjedhjes së rrymës. "Vendosja e njësorëve digjitalë ose njësive matëse në shtyllat elektrike apo në hyrje të shtëpive mund ta parandalojnë vjedhjen. Matës të tillë regjistrojnë sa energji kalon deri aty. Dhe nga ai vend, KEDS-i më pas e di se sa është vjedhur rryma sepse nuk faturohet", ka thënë Dragusha.

KEDS-i ka thënë se ka investuar në njësorë digjitalë dhe njësi matëse dhe këto investime kanë ndikuar që ndër vite të bie niveli i

vjedhjes së rrymës. Megjithatë, kjo kompani thotë se humbjet e energjisë ende janë të mëdha. Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka thënë se nga 630 mijë njësorë, tashmë rreth 500 mijë prej tyre janë digjitale. "Kjo ka ndikuar në zvogëlimin e humbjeve", ka thënë Buzhala, duke shtuar se humbjet teknike dhe komerciale më 2013, kur ka nisur operimin KEDS-i pas privatizimit, kanë qenë 32 për qind. Sipas Viktor Buzhalës, KEDS-i për çdo vit dorëzon në gjykata rreth 5 000 kallëzime penale për keqpërdorim të energjisë elektrike. Por, përveç digjitalizimit të njësorëve,

Besfort Kosova, menaxher në iniciativën rajonale "Balkan Green Foundation", ka vlerësuar se mosefikasiteti i gjyqësorit ka ndikuar në përqindjen e lartë të keqpërdoruesve të rrymës.

Edhe zëdhënësi i KEDS-it ka thënë se nëse këto raste do të shqyrtoheshin nga gjykatat, "ky problem nuk do të ekzistonte". "Rreth 80 për qind e lëndëve për një kohë të gjatë nuk janë shqyrtuar fare", ka thënë Buzhala.

"REL"-i ka pyetur edhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës se sa lëndë janë zgjidhur deri më tash dhe sa janë të pazgjidhura, por nuk ka kthyer përgjigje.

Edhe Ministria e Ekonomisë ka njoftuar se është duke ndërmarrë masa për ta dhënë ndihmën e duhur në ndërprerjen e përdorimit të paautorizuar të energjisë elektrike së bashku me organet ligjzbatuese dhe kompaninë KEDS-i. Nga ky institucion kanë paralajmëruar se do të merren masa shtesë për këtë dukuri. Vjedhja e energjisë elektrike jo vetëm që është vepër penale sipas Kodit Penal, thuhet në njoftim të kësaj ministrie të datës 16 gusht, por tashmë ajo përbën "kosto e papërbalueshme që duhet të paguhet nga paratë e të gjithëve".

Tahiri: Paaftësia e qeverisë dhe KEK-ut po i kushton Kosovës 56 milionë euro humbje në muaj



PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Zyrta i lartë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Xhafer Tahiri, ka thënë se Kosova ka humbur 56 milionë euro për energji që nga 19 korriku. "130 MWh energji nuk po prodhohen në 'Blokun A5' në KEK nga 19 korriku 2022. Me koston aktuale të energjisë në bursa, kjo në numra i bie humbje prej 78 mijë eurosh në orë, ose 1 milion e 870 mijë euro në ditë apo 56 milionë euro në muaj. Kjo humbje do të vazhdojë deri kur A5 të rikthehet në prodhim", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Për këtë situatë Tahiri ka

fajësuar qeverinë dhe bordin e KEK-ut. "Pra, 56 milionë euro në muaj Kosovës po i kushton paaftësia e qeverisë dhe bordit të KEK-ut, sepse KEK-u për 1 vit nuk ka arritur të fillojë remontet në 'Blokun A5', e është detyruar që për shkaqe teknike, nga 19 korriku, ta ndalë 'Blokun A5'. As kontratë për remont të këtij bloku KEK-u nuk ka!", ka shkruar Tahiri.

Më tutje, Tahiri ka thënë se këto mjete shteti do të mund t'i investonte në disa fusha të tjera. "Çka kish me bërë Kosova me 56 milionë euro në muaj? P.sh kish me ndërnuar kopshte për fëmijë

në krejt Kosovën ose nga buxheti i Kosovës në vend që këto para me i harxhuar me ble energji, ishin përdorë me i rritë pagat e mësuesve e të mjekëve. Pse remonti i 'Blokut A5' nuk ka ndodhë në kohë? Sepse tenderi për remont me gjasë ju ka përgatitë dostave të bordit të zgjedhur nga kjo qeveri, tenderi ka dështuar, 'Blokun A5' është ndalur, KEK prodhon 130 MWh më pak ndërsa nga buxheti i shtetit po shpenzohet me ble energji, e prapë kemi reduktime në pikë të verës. Terri ka adresë!", ka shkruar Tahiri.

Dogana parandalon gjashtë raste të kontrabandës të mallrave ushqimore

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar se gjatë ditëve të fundit ka parandaluar gjashtë raste të tentimkontrabandës. Sipas njoftimit, janë ndaluar vaj ushqimor, pije jooalkolike dhe çokollata. "Njësitë e Doganës së Kosovës kanë pasur një javë të suksesshme në parandalimin

dhe kontrabandimin, ku kanë parandaluar gjashtë raste të tentimkontrabandës. Fillimisht në Mitrovicë, njësitet e anti-kontrabandës të Doganës së Kosovës në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë arritur të identifikojnë dhe ndalojnë një automjet transportues i cili ishte duke transportuar 1 500

litra vaj ushqimor të kontrabanduar nga Serbia përmes rrugëve ilegale", ka njoftuar dogana. Në regionin e Prizrenit gjatë kontrolleve të një ngarkese është vërtetuar se malli-badema nuk kishte dokumentacion mbi prejardhjen e tij, ku sasia e tyre ishte rreth 680 kilogramë.



Çfarë kërkon Kina?

Nga Hal BRANDS &
Michael BECKLEY
"Foreign Policy"

Katastrofat më të mëdha gjeopolitike ndodhin kur përzihen bashkë ambicia dhe dëshpërimi. Shumë shpejt, Kina e Xi Jinping do të drejtohet nga të dyja këto ndjenja. Në librin tonë të ri, "Zona e rrezikut: Konflikti i ardhshëm me Kinën", ne shpjegojmë edhe shkakun e atij dëshpërimi: një ngadalësim i ekonomisë dhe një ndjenjë fortë e rrethimit dhe rënies.

Por së pari, ne duhet të parashikojmë madhësitë e këtyre ambicioneve, pra atë që po përpiqet të arrijë Kina e Xi-së. Është e vështirë të kuptohet se sa e madhe do të jetë rënia e Kinës, pa kuptuar lartësitë në të cilat synon të ngjitet Pekini. Partia Komuniste Kineze (PKK), po zbaton një projekt epik për të rishkruar rregullat e rendit global në Azi dhe shumë më gjerë.

Kina nuk dëshiron të jetë një superfuqi dosido, pra një pol nga shumë të tilla në sistemin ndërkombëtar. Ajo dëshiron të jetë superfuqia kryesore, "dielli" gjeopolitik rreth të cilit rrotullohet sistemi. Dhe tani kjo ambicie është e vështirë të braktiset. Madje ajo është edhe më e qartë në atë që po bën PKK, nga programi i saj i ndërtimit të anijeve detare, deri tek përpjekjet për ta ribërë gjeografinë strategjike të Euroazisë.

Zyrtarët e PKK shfaqen të sigurt në publik, kur deklarojnë se një Kinë në rritje po eklipson një Shtetet e Bashkuara në rënie. E megjithatë në prapaskenë, liderët në Pekin janë tashmë të shqetësuar se ëndrra kineze mund të mbetet pikërisht e tillë, vetëm një ëndërr. Ka shumë prova se PKK po ndjek një strategji të madhe me 4 objektiva kyçe.

Së pari, PKK ka ambicien e përjetshme të çdo regjimi autokratik: të ruajë kontrollin e saj të hekurt mbi pushtetin. Që nga viti 1949, regjimi kinez e ka parë gjithmonë veten si të bllokuar në luftë me armiq të brendshëm dhe të jashtëm. Udhëheqësit e saj janë të tmerruar nga shembja e Bashkimit Sovjetik. Ata e dinë se rënia e sistemit të udhëhequr nga PKK do të ishte një fatkeqësi personale për ta. Ndaj në politikën kineze, paranoja është virtyt dhe jo ves.

Së dyti, PKK dëshiron ta bëjë Kinën sërish të plotë, duke rifituar territoret e humbura në epokat e mëparshme të trazirave të brendshme si dhe të agresionit të huaj. Harta e Kinës e Xi Jinping përfshin një Hong Kong që është riinkorporuar plotësisht në shtetin e udhëhequr nga PKK,



dhe një Tajvan që synohet të rikthehet nën kontrollin e Pekinit.

Diku tjetër përgjatë periferisë së saj, PKK ka mosmarrëveshje të pazgjidhura kufitare me vende të shumta, nga India në Japoni. Po ashtu Pekini pretendon si të vetën rreth 90 për qind të Detit të Kinës Jugore, një nga rrugët ujore më të rëndësishme tregare në botë. Zyrtarët kinezë thonë se për këto çështje nuk ka vend për kompromis. "Ne nuk mund të humbasim as një cm të territorit të lënë trashëgim nga paraardhësit tanë" - i tha Xi Sekretarit amerikan të Mbrojtjes James Mattis në vitin 2018.

Synimi i tretë i PKK, është të krijojë një sferë rajonale ndikimi, në të cilën Kina të jetë nëqendër, dhe aktorët e jashtëm, veçanërisht SHBA-ja, të shtyhen në periferi. Ndoshta Pekini nuk ka ndërmend atë lloj dominimi të plotë fizik që ushtroi Bashkimi Sovjetik në Evropën Lindore gjatë Luftës së Ftohtë. Përkundrazi, PKK parashikon përdorimin e një përzjerjeje të taktikave të joshjes dhe forcës, për të garantuar që ekonominë e Azisë të jenë të orientuara drejt Pekinit dhe jo drejt Uashingtonit, që fuqitë më të vogla të respektojnë siç duhet PKK, dhe që SHBA-ja të mos ketë më prani ushtarake në rajon.

Siç u shpreh Xi në vitin 2014: "I takon popullit të Azisë të drejtojnë punët e Azisë, të zgjidhë problemet e Azisë, dhe të mbështesë sigurinë e Azisë". Zyrtarë të tjerë kanë qenë edhe më të qartë. Në vitin 2010, ministri i jashtëm i atëhershëm Yang Jiechi u tha 10 vendeve të Azisë Juglindore: "Kina është një

vend i madh, ju jeni vende të vogla, dhe ky është një fakt!"

Objektivi i katërt dhe i fundit i strategjisë së Pekinit, përqendrohet në arritjen e fuqisë globale dhe përfundimisht të epërsisë globale. Mediat shtetërore dhe zyrtarët e partisë, kanë shpjeguar vazhdimisht se një Kinë gjithnjë e më e fuqishme, nuk mund të ekzistojë e qetë në një sistem të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara.

Në këtë kuadër, Xi ka folur për krijimin e një "komuniteti global të fateve të përbashkëta", që do të përfshinte të gjithë, dhe që me sa duket t'i binden udhëzimeve "atërore" të PKK. Për Xinhua, agjencinë shtetërore të lajmeve, nuk ka asnjë dilemë se kush do të diktojë çështjet globale pasi të arrihet ripërtëritja kombëtare e Kinës: "Deri në vitin 2050, dy shekuj pas Luftërave të Opiumit, të cilat e zhytën 'Mbretërinë e Mesme' në një periudhë lëndimi dhe turpi, Kina është e vendosur të rifitojë fuqinë e saj dhe të ngjitet sërish në krye të botës". Lufta për t'u "bërë nr.1 në botë... është një luftë popullore", deklaroi nga ana tjetër gazeta nacionaliste "Global Times". "Ajo do të jetë e madhe dhe e fuqishme sa një lumë i madh. Do të jetë një valë e pandalshme". Katër objektivat e strategjisë së madhe kineze përparojnë që të gjitha së bashku.

PKK pretendon se vetëm nën udhëheqjen e saj, Kina mund të arrijë "përtëritjen e saj kombëtare" të shumëpritur. Nga ana tjetër kërkimi i fuqi sërëonale dhe globale, duhet tapërforcojë autoritetin e PKK në vend, duke e nxitur nacionalizmin kinez në një kohë kur është braktisur

ideologjia origjinale e regjimit, socializmi.

Dhe ajo mund t'i japë Kinës aftësinë, të cilën ajo po e përdor në mënyrë agresive, për t'i mbyllur gojën kritikëve të saj ndërkombëtarë, dhe për të krijuar rregulla globale që mbrojnë një shtet autokratik. Ndërkaq, strategjia e madhe kineze përfshin shumë më tepër sesa mbrojtjen e e vendit dhe regjimit të tij qeverisës.

Këto synime janë të lidhura ngushtë me ndjekjen e një ndryshimi epokal në rregullat rajonale dhe globale të rrugës, si ai që ndodh kur një hegemon bie dhe ngrihet një tjetër. "Perandoritë s'kanë asnjë interes të veprojnë brenda një sistemi ndërkombëtar. Ato aspirojnë të jenë vetë sistemi ndërkombëtar"- shkruan ish-Sekretari amerikan i Shtetit Henry Kissinger në librin e tij "Diplomacia".

Kjo është sot ambicia përfundimtare e Kinës. Amerikanët mund të habiten kur zbulojnë se liderët kinezë e shohin SHBA si një komb të rrezikshëm dhe armiqësor, që është i vendosur të mbajë nën kontroll vendet e tjera. Nga Mao Ce Duni tek Xi, udhëheqësit kinezë i kanë parë SHBA-të si një kërcënim për primatin politik të PKK.

Kur Shtetet e Bashkuara dhe Kina u shpallën armiq midis tyre gjatë fillimit të Luftës së Ftohtë, Uashingtoni sponsorizoi rebelët tibetianë që luftuan kundër atij regjimi, duke mbështetur edhe Chiang Kai-Shek në Tajvan, dhe pretendimin e tij si sundimtari i ligjshëm i Kinës.

Dekadat e fundit, udhëheqësit amerikanë kanë këmbëngulur se i duan të mirën Kinës. Por ata kanë shpallur gjithashtu atë që presidenti Bill Clinton e

cilësoi në vitin 1997 si modeli politik autoritar që e vendos këtë vend "në anën e gabuar të historisë". Pas masakrës në Sheshin Tiananmen, dhe në kundërpërgjigje të mizorive të PKK kundër popullsisë ujgure kohët e fundit, Shtetet e Bashkuara i kanë nxitur aleatet dhe partnerët të vendosin sanksione ekonomike ndaj Kinës.

Edhe kur SHBA nuk ka një plan konkret për të rrëzuar diktatorët, ajo nuk mund të mos i kërcënojë ata. Vetë ekzistenca e Amerikës shërben si një fener shprese për disidentët. Shtetet e Bashkuara e pengojnë rrugën e Kinës drejt madhësisë edhe në mënyra të tjera.

PKK nuk mund ta bëjë Kinën të plotë përsëri pa rimarrë Tajvanin, por Shtetet e Bashkuara e mbrojnë atë ishull, nëpërmjet shitjeve të armëve, mbështetjes diplomatike dhe premtimit të nënkuptuar për ndihmë ushtarake. Në mënyrë të ngjashme, Shtetet e Bashkuara pengojnë përpjekjet e Kinës për dominim në Detin e Kinës Jugore me marinën dhe thirrjet e saj për lirinë e lundrimit; aleancat ushtarake dhe partneritetet e sigurisë në Azi, që u japin vendeve më të vogla guximin për t'i rezistuar pushtetit kinez.

Prandaj Kina do ta luftojë fort për t'ia kaluar Shteteve të Bashkuara në terma afatgjatë. Pikërisht për këtë arsye, në të ardhmen e afërt ajo mund të jetë më e rrezikshme.

Marrë me shkurtime

Shënim: Hal Brands, profesor i çështjeve në Shkollën Xhon Hopkins të Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare. Michael Beckley, profesor i asociuar i shkencave politike në Universitetin Tafts.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ballkani e Gjilani fitojnë, Prishtina barazon në Ferizaj

PRISHTINË, 21 GUSHT - Janë zhvilluar tri ndeshjet e tjera në kuadër të xhiros së dytë në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra kampione në fuqi, Ballkani, e ka zhvilluar ndeshjen e parë të këtij edicioni në elitë, duke realizuar fitore në duel me Drenicën. Ndeshja e zhvilluar në orët e mbrëmjes në stadiumin "Fadil Vokrri" është mbyllur 1:0. Golin e tri pikëve të para për portokallezinjtë e ka realizuar kapiteni Edvin Kuç, me një gjuajtje të saktë nga brendësia e zonës pas asistimit të Gripshit. Gjilani ka realizuar fitoren e dytë radhazi, duke u bërë lider i renditjes në elitë. Skuadra e Zekirija Ramadanit, të dielën, në fushën me bari sintetik në Gjilan, e ka mundur Malishevën me rezultat 1:0. Edhe këtë herë përcaktues në fitoren e gjilanasve ishte përforsimi i

ri, Theophilus Solomon, i cili realizoi në minutën e 67-të, me gjuajtje me kokë pas harkimit të Mevlan Zekës. Ndërkohë, Ferizaj dhe Prishtina kanë luajtur baras (0:0), në një ndeshje ku nuk kanë munguar rastet nga të dyja palët, por ka munguar finalizimi i rasteve. Më afër golit ishte Endrit Krasniqi i Prishtinës, por gjuajtja e tij e qëllloi shtyllën. E në minutën e 33-të gjyqtari Erdall Zasella akordoi penallti, por e cila më pas me ndihmën e VAR-it u shfuqizua. Si rrjedhojë në këtë rast pati vonesë për rifillimin e ndeshjes, pasi si pasojë e këputjes së kabllos së sinjalit nga ana e disa tifozëve të pandërgjegjshëm, gjyqtari Zasella nuk kishte mundësi ta shikojë rastin diskutabil në monitorin që është në fushë, përderisa ekipi teknik i FFK-së e riktheu sinjalin tek monitori i VAR-it në fushë me një



kablo tjetër. Drita ka shijuar fitoren e parë në këtë edicion, pasi para tifozëve të vet e ka mundur Dukagjinin, me rezultat 1:0. Golin e

vetëm në këtë duel e ka shënuar sulmuesi maqedonas, Marko Simonovski, në minutën e 59-të. Për Dukagjinin kjo ishte

humbja e dytë, pasi në hapje të kampionatit u mposht në shtëpi nga Prishtina. Lojë shumë më interesante u zhvillua në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, ndërmjet Llapit dhe Trepçës'89, e cila në fund u mbyll baras 2:2. Llapjanët shënuan të parët me golin e Adem Maliqit, në minutën e 26-të. Megjithatë, "minatorët" e përmbysën rezultatin në pjesën e dytë me dy golat e Albion Pllanës, në minutat 74-t dhe 80-të, duke e shfrytëzuar epërsinë numerike në fushë, ngase në minutën e 69-të Benjamin Emimi u ndëshkua me karton të kuq. Mirëpo, në minutat e fundit mysafirëve iu kushtojë një pakujdesi në repartin e mbrojtjes, kur Fatmir Rexhaj shënoi autogol. Në minutat shtesë të dyja ekipet patën mundësi për të shënuar golin, por në vend të rrjetës qëlluan shtyllën.

Kampione e Evropës, Luiza Gega: Studiova konkurrentët dhe bëra një garë taktike



TIRANË, 21 GUSHT - Kampionia më e re e Evropës në atletikë në garën 3000 m me pengesa, është padyshim Luiza Gega nga Shqipëria, e cila ende i ruan emocionet e finales së një nate më parë. Ajo shprehet se ndihet shumë e lumtur për këtë arritje dhe shumë krenare që përfaqëson Shqipërinë. "Ishte një emocion shumë i madh! Konkurrentët kryesorë ishin shumë të përgatitur dhe unë i kam

studiuar dhe jam mundur që të bëj një garë taktike. Po ashtu gjatë gjithë kohës ndoqa këshillat e trajnerit. Më ndihmoi gjatë të gjitha xhirove për të arritur më shpejt se të tjerët atë vijën e binishit", ka thënë Gega. "Është i rëndësishëm medalja dhe pozicioni! Ndihej shumë e lumtur dhe shumë e vlerësuar dhe jam shumë krenare që jam shqiptare dhe që përfaqësoj këtë komb! Mund t'i kemi

gjërat më të vështira sesa shtete e zhvilluara, por gjithsesi dhe pse në vështirësi nëse e do vërtetë atë që bën dhe je i durueshëm mund t'ia dalësh! Jam shumë krenare. Ka shtete që vijnë me 30 sportistë dhe nuk marrin medalje ari. Jam ndjerë shumë e vlerësuar dhe nga komentet e shteteve të huaja. Akoma i kam emocionet. Jam më mirë se kurrë më parë", ka shtuar Gega për "Report Tv".


Barcelona synon rikthimin e Messi

BARCELONË, 21 GUSHT - Barcelona do të tentojë të rinëshkruajë Lionel Messin nga Paris Saint-Germain brenda vitit të ardhshëm.

Menaxheri Xavi është i etur për të forcuar më tej skuadrën e tij gjatë sezoneve të ardhshme. Dhe një lojtar që ai është i vendosur të

sjellë është Messi. Sipas gazetës spanjolle Sport, drejtuesit e Barçës duan të shohin që shtatë herë fituesi i Topit të kthehet në "Nou

Camp" më shpejt. Por, ata nuk pritet të bëjnë një ofertë të mëparshme deri pas Botërorit të Katarit, i cili fillon në nëntor.



Hajvalia e mbyll me fitore aventurën në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 21 GUSHT - Skuadra kampione në fuqi e Kosovës, EP-Com Hajvalia ka marrë pjesë në garat e raundit të parë të Ligës së Kampionëve për femra, që janë mbajtur në Holandë. Në ndeshjen

gjysmëfinale të Grupit 8, që u zhvillua të enjten, vashat e udhëhequra nga Suad Keqi pësuan humbje të thellë nga skuadra favorite, Benfica, me rezultat 9:0. Ndërkaq, të dielën kampionet tona në

ndeshjen për vendin e tretë shënuan fitore bindëse ndaj kampiones së Moldavisë, Agarisa Anenni Noi, me rezultat 7:0. Fortesa Berisha ka shënuar katër gola, derisa nga një gol e kanë realizuar

Fatlinda Ramaj, Feride Kastrati dhe Qëndresa Krasniqi. Në finale të grupit do të takohen Twente dhe Benfica, e ku skuadra fituese do të avancojë tutje në raundin e dytë.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 Shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

- I. Zyrtar Ligjor 2, njëzetetë (23) vende pune**
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Prishtinë, tetë (8) pozita
Prokuroria Themelore Gjilan, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Pejë, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Mitrovicë, tri (3) pozita
Prokuroria Themelore Gjakovë, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Ferizaj, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Prizren, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 015
Emri pozitës:	Zyrtar Ligjor 2
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional
Kodi punës:	L1/060
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Njëzetetë (23) pozita
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi :	Prishtinë, Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Prizren

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve të Prokurorit duke i ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve, shkresave dhe daktilografimin e tyre si dhe mbajtjen e evidencave për lëndët në proces dhe të kryera nga Prokurori e në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Shkrimores së Prokurorisë dhe Udhëheqësin e Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ndihmon në mënyrë profesionale Prokurorin me daktilografim profesional të akteve që i nxjerrë prokurori lidhur me lëndët konkrete të besuara për ndërmarrjen e veprimeve akuzuese nga prokurori;
Pranon lëndët e ndara për prokurorin me të cilin punon, evidentimin e tyre në mënyrë elektronike dërgimin e lëndëve me shkresat përcjellëse në shkrimore, mbajtjen e evidencës për lëndët në proces dhe lëndët e kryera, raporton për punën e vet të Udhëheqësi i Administratës;
Merr pjesë në procesin e dëgjimit të palëve duke e mbajtur procesverbalin e marrjes në pyetje, ruan konfidencialitetin e lëndës dhe palëve;
Kryen të gjitha punët përgatitore për praninë e palëve para prokurorit me dërgesën e ftesave dhe pranimin e konfirmimeve nga dorëzuesit e shkresave;
Gjithnjë kujdeset për informimin e Prokurorit lidhur me praninë e tij në gjykime, duke mos e lënë anash informimin lidhur me shkresat e ndryshme apo (corpora deliktet) që ndërlihen me lëndën gjyqësore;
Përgjegjës për kryerjen e punës në mënyrë sa më profesionale, duke u kujdesur që gjatë punës së besuar të ketë sa më pak lëshime;
Për punën e vet i përgjegjës udhëheqësit të administratës, ndërsa për punën e kryer me prokurorin lidhur me lëndët mbanë edhe përgjegjësi tek prokurori i çështjes, andaj kërkohet një sy çelësi dhe vëmendje e veçantë;
I obliguar të respektojë Kodin e Etikës Profesionale të stafit mbështetës dhe Kodin e Shërbimit Civil;
Kryen edhe punë tjera që ndërlihen me pozitën e tij/saj duke i zëvendësuar kolegët tjerë në punë.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi juridik dhe administratë publike;
Njohuri të mirë të gjuhës shqipe, dhe/ose serbe e dëshirueshme, në të shprehur me gojë dhe me shkrim duke përfshirë aftësi të zhvilluara në hartimin e dokumenteve;
Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.) dhe internetin;
Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I/E gatshëm/e të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

Një (1) vit përvojë pune profesionale.

II. Zyrtar për Pasuri, një (1) vende pune

Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/POZ - 016
Emri pozitës:	Zyrtar për Pasuri
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional
Kodi punës:	BF/260
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Vlerëson, evidenton, mbikëqyrë dhe siguron përdorimin e pasurisë sipas nevojave të sistemit prokurorial.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Vlerëson dhe planifikon nevojat e sistemit prokurorial për pasuritë jo financiare;
Propozon rregulla për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe siguron zbatimin e të gjitha rregullave në fuqi përmes sistemeve të krijuara të kontrollit dhe mbikëqyrjes;
Mban evidencë elektronike dhe fizike, siguron barkodimin dhe përgatit raporte të ndryshme periodike dhe vjetore për gjithë pasurinë e sistemit prokurorial;
Përmes propozimeve për proceduara përkatëse ndihmon procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurisë jo financiare;
Rekomandon njësitë organizative të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit lidhur me mënyrën e menaxhimit të pasurisë;
Azurnon regjistrin e pasurive jo financiare pas çdo procesi të inventarizimit, vlerësimit dhe tjetërsimit të pasurisë jo financiare.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Njohja dhe aplikimi i programeve të Microsoft Office, si dhe softuerëve dhe web aplikacioneve;
Aftësitë e koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit me zyrtaret dhe palët;
Shkathtësi të shkëlqyera organizative dhe ekipore si dhe për të punuar me udhëheqje minimale mbikëqyrëse;
Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në limite kohore;
Fleksibiliteti dhe aftësia që të punoj me vëllim pune.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik.

Përvoja e Punës:

Dy (2) vjet përvojë pune profesionale.

III. Zyrtar për Transport 3, një (1) vende pune

Prokuroria Themelore Gjakovë, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 017
Emri pozitës:	Zyrtar për Transport 3
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ
Kodi punës:	AD/1110
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pesë pikë pesë (5.5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institucionit.
Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta lidhura transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kryen punën e vozitjes së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;
Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar;
Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;
Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;
Mban të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;
Kujdeset që automjetet e institucionit të përdoren në mënyrë sa më racionale;
Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;
Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së vozitësit;
Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioriteteve;
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion.
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Shkolla e Mesme, Patentë Shoferi Kategorja "B".

Përvoja e punës:

Së paku 3 vite përvojë pune.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 22.08.2022 deri me datë 05.09.2022 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2021 od 15 Februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljivanje:

KONKURS

- I. Pravni Službenik 2, dvadesettri (23) radnih mesta**
 Specialno Tužilaštvo Republike Kosovo, tri (3) pozicije
 Osnovno Tužilaštvo Priština, dosam (8) pozicije
 Osnovno Tužilaštvo Gnjilane, tri (3) pozicije
 Osnovno Tužilaštvo Peć, tri (3) pozicije
 Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, tri (3) pozicije
 Osnovno Tužilaštvo Đakovica, jedna (1) pozicija
 Osnovno Tužilaštvo Uroševac, jedna (1) pozicija
 Osnovno Tužilaštvo Prizren, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 015
 Naziv Pozicije: Pravni Službenik 2
 Pozicija: Pozicija od karijere
 Nivo: Profesionalni
 Radni kod: LI/060
 Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
 Broj Pozicija: Dvadesettri (23) pozicije
 Koeficijenti: Sedam (7)
 Akt imenovanja: Na neodređeno
 Probni rad: Dvanaest (12) meseci
 Mesto: Priština, Gnjilane, Peć, Mitrovica, Đakovica, Uroševac, Prizren

Cilj radnog mesta:

Preduzima sve konkretne radnje i profesionalne inicijative za obavljanje efektivnijeg i kvalitativnijeg poslova Tužilaca, pružajući pravnu stručnu podršku uz izradu akata, spisa i njihovom daktilografiranju, kao i vodi evidencije o predmetima koji su u postupku i koji su završeni od strane tužioca u saradnji sa Nadzornikom Pisarnice Tužilaštva i Rukovodiocem Administracije.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Pomaže na profesionalan način Tužiocu uz profesionalno daktilografiranje akata koje iznese tužilac u vezi konkretnih poverenih predmeta za preduzimanje optužnih radnji od strane tužilaca;

Prima predmete koji su dodeljeni za tužioca sa kojim radi, njihovo elektronsko evidentiranje, dostavljanje predmeta uz pratećih spisa u pisarnici, vođenje evidencije za predmete koji su u postupku i o završenim predmetima, izveštava o svom radu Rukovodioca Administracije/ Administratora;

Učestvuje u procesu saslušanja stranaka vodeći zapisnik ispitivanja, sačuva konfidencijalnost predmeta i stranaka;

Obavlja sve pripremne poslove za prisustvo stranaka pred tužiocem uz slanjem pozivnice i primanjem potvrde od dostavljača dopisa;

Uvek se pobrine za informisanje Tužioca u vezi njegovog prisustva na suđenja, ne zanemarujući informisanje u vezi različitih spisa ili (corpora delikti) koji se nadovezuju sa predmetom;

Odgovoran za obavljanje poslova na stručan način, pobrineći se da tokom posla koji mu je poveren ima što manje propusta;

O svom radu odgovara Rukovodiocu Administracije, a za obavljeni rad sa tužiocem u vezi sa predmetima vodi odgovornost i kod tužioca predmeta, stoga se zahteva posebna pažnja i trezvenost;

Obavezan da poštuje Kod Profesionalne Etike pomoćnog osoblja i kod o civilnoj službi;

Obavlja i ostale poslove koje su vezane sa njegovom pozicijom, zamenjući ostale kolege na poslu.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlučna sveobuhvatna stručna znanja iz Javne Upravne Pravne oblasti;

Dobro poznavanje albanskog, i/ ili srpskog je poželjno, u pismenom i usmenom izražavanju, uključujući razvijene sposobnosti u izradi dokumenata

Znanja sa dobrim kompjuterskim radnim sposobnostima uz aplikacije programa (Microsoft Word, Excel;

Stručna Sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet.

Radno Iskustvo:

Jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva.

- II. Službenik za Imovinu, jedna (1) radnih mesta**
 Sekretarijatu Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/POZ - 016
 Naziv Pozicije: Službenik za imovinu
 Pozicija: Pozicija od karijere
 Nivo: Profesionalna 3
 Radni kod: BF/260
 Raportira kod: Rukovodiocu Divizije za Opšte Usluge
 Broj Pozicija: Jedna (1) pozicija
 Koeficijenti: Sedam (7)
 Akt imenovanja: Na neodređeno
 Probni rad: Dvanaest (12) meseci
 Mesto: Priština

Cilja radnog mesta:

Ocenjuje, evidentira, nadzira i obezbeđuje korišćenje imovine prema potrebama tužilačkog sistema.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Ocenjuje i planira potrebe tužilačkog sistema za nefinansijsku imovinu;

Predlaže pravila za upravljanje nefinansijskom imovinom i obezbeđuje implementaciju svih

važćih pravila putem ispostavljenih sistema kontrole i nadzora;
 Vodi elektronsku i fizičku evidenciju, obezbeđuje bar kodiranje i priprema razne periodične i godišnje izveštaje za svu imovinu tužilačkog sistema;
 Kroz predloge za odgovarajuće postupke pomaže proces inventarizacije, ocenjivanje i otuđivanje nefinansijske imovine;
 Preporučuje organizativne jedinice Saveta i Državnog Tužioca u vezi sa načinom upravljanja imovinom;

Ažurira registra nefinansijske imovine nakon svakog procesa inventarizacije, ocenjivanja i otuđivanja nefinansijske imovine;

Obezbeđuje tačne i potpune podatke u registru nefinansijske imovine;

Obavlja ostale obaveze koje je odredio nadzornik.

Znanje, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Poznavanje i primena aplikacija programa Microsoft Office, kao i softvera i veb aplikacija;

Sposobnosti u koordiniranju, saradnji i komunikaciji sa zvaničnicima i strankama;

Odlučne organizativne i ekipne veštine kao i rad uz minimalni nadzor upravljanja;

Da ima sposobnost da radi pod pritiskom i pod vremenskim ograničenjem;

Fleksibilnost i sposobnost da radi obimnim radom.

Stručna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Ekonomski Fakultet .

Radno Iskustvo:

Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva.

- III. Službenik za Transport 3, jedna (1) radnih mesta**

Osnovno Tužilaštvo Đakovica, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ -017
 Naziv pozicije: Službenik za Transport 3
 Pozicija: Pozicija karijere
 Nivo: Administrativno
 Radni kod: AD/1110
 Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
 Broj pozicija: Jedna (1) pozicije
 Koeficijent: Pet tačka pet (5.5)
 Akt imenovanja: Na neodređeno
 Probni rad: Dvanaest (12) meseci
 Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

Pružanje usluga prevoza tužioca službenika i osoblja institucije. Pažljiv za direktnim aktivitetima vezana za transport u instituciju i održavanje vozila.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Završava posao vozača tužilaca i službenika na osnovu rasporeda službenih odredbi na nivou tužilaštva ;

Održava vozilo sa kojim završava službene obaveze ili sa kojim je zadužen ;

Prisutan u toku planiranja za pripremu programa na polju transporta i obezbeđuje održavanje poslova vezano za usluge transporta;

Odgovoran je za obezbeđenje servisa i održavanja transportnih vozila institucije;

Da drži evidenciju korišćenja, servisa vozila i spremiti potrebnu dokumentaciju za njihovo korišćenje ;

Stara se da vozilo institucije da se koriste na racionalan način;

Pruža usluge transporta po potrebi ;

Obavlja i druge zadatke u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje može zatražiti od direktnog pretpostavljenog.

Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Potrebno profesionalno znanje za obavljanje zadataka vozača

Sposobnosti za određivanje i procenu posla po zadatim prioritetima

Spreman da radi sa ljudima raznih entiteta i religija

Da je spreman za obavljanje posla pod pritiskom

Sposobnosti korišćenja računara i programa (Word, Excel, Power Point, Access, Internet)

Stručna sprema i Stručna sprema i kvalifikacija:

Srednja Škola, Vozačka Dozvola Kategorija „B“ .

Radno iskustvo:

Najmanje 3 godine radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 22.08.2022 do 05.09.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzete se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:
 - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
 - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
 - „Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specificovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova“.
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije–fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Datë: 19.08.2022
Nr. Prot. 581/1

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2022/2023 Prishtinë, gusht 2022

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjinnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2022/23, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e X-të në IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjinnaze dhe IAAP s për vitin shkollor 2022/2023, bëhet më datën 22, 23 dhe 24 gusht 2022 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 25.08.2022.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 26.08.2022.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë behën në Agjencinë për Arsimi dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese per gjinnaze dhe shkolla te mesme te mjeksise eshte qe mesatarja e ketyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatave te atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjinnaze dhe shkolla te mesme të mjeksisë është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
 $\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)} + \text{mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- **Shëndetësi, Bujqesi, Teknologji Ushqimore. dhe Veterinari:**
Biologji, Kimi, Fizikë Gjuhe shqipe dhe letërsi,
- **Makineri, Elektroteknikë, TIK. Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë**
Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë Shqipe dhe letërsi
- **Ekonomi, Administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

• Juridik dhe Administratë:

Gjuhe shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

• Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:

Gjuhë shqipe dhe letërsi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

• Shkollat Artistike:

Gjuhë amtare dhe letërsi Edukat qytetare, Art, Muzikë

• Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

• Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë, duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

2. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Shkollat e Shëndetësisë** – Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes(Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë_shqipe)}}{4} \geq 4$$

- Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe informatikë 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |

Totali = 40 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Shkenca natyrore 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca shoqërore 25 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |

Totali = 40 pikë

III. Ekonomi

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Shkenca shoqërore 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat natyrore 25 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |

Totali = 40 pikë

IV. Juridik

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | 50 x 0.05 = 5 pikë |

Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |

Totali = 40 pikë

VI. Shkollat Artistike

- | | |
|--------------------------------------|----------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | 50 x 0.4 = 20 pikë |
| 2. Shkenca shoqërore 25 | 50 x 0.2 = 10 pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | 50 x 0.15 = 7.5 pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | 50 x 0.05 = 2.5 pikë |

Totali = 40 pikë

KONKURSI PER QENDRAT E KOMPETENCES 2022/23

Mësimi në gjuhën shqipe								
Vendi	Shkolla	Drejtimit	Profilet	paralelet	Nr.Nxënë sve	Vitet		
Prizren	"11 Marsi"	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	Informatikë	1	8	2+1		
			Telekomunikacionit	1	8	2+1		
			Teknik i sistemeve të TIK	1	2	2+1		
			Trafik rrugor	1	7	2+1		
		Makineri, Prodhim dhe Nderimtari	Mekatronikë	1	13	2+1		
			Elektronikë	1	14	2+1		
			Instalues elektrik	1	14	2+1		
			Automekanik	1	21	2+1		
						2+1		
			Metalpunues/Saldues	1	15	2+1		
			Teknik i dizajnit grafik	1	7	2+1		
			Arkitekturë	1	6	2+1		
			Teknik i izolimit të ndërtesave	1	21	2+1		
						2+1		
		Arte	Dizajn enterieri	1	12	2+1		
			Konfeksion	1	15	2+1		
		Gjithsej- Sh. "11Marsi" Gj. shqipe				14	163	2+1
		Mësimi në gjuhën boshnjake						
		Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit	Arkitekturë	1	10	2+1	
				Zhvillues i aplikacioneve Softverike	1	9	2+1	
Arte		Konfeksion	1	13	2+1			
		Gjithsej- Gj. Boshnake	3	52	2+1			
Arte		Dizajn enterieri	1	16	2+1			
		Gjithsej- Gj.Turke	1	16	2+1			

Vendi	Shkolla	Drejtimit	Profilet	paralelet	Nr.Nxënë sve	Vitet	
Prishtinë	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi"	Makineri, prodhim dhe ndertimtari	Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	06	2+1	
			Metalpunues	1	16	2+1	
						2+	
						2+1	
			Mekatronikë	1	11		
			Trafik rrugor	1	12	2+1	
			Transport rrugor	1	20	2+1	
		Levizje e trenave	1	22	2+1		
		Arte					2+1
							2+1
Shërbime					2+1		
					2+1		
Gjithsej - "Sh. Gjeçovi"				6	87		

Vendi	Shkolla	Drejtimit	Profilet	paralelet	Nr.Nxënë sve	Vitet	
Prizren	Qendra e Kompetences	Ekonomi, administrim dhe juridik	Financa	1	24	2+1	
			Nepunes finance	1	24	2+1	
			Marketing	1	24	2+1	
			Shërcime ndaj Konsumatorit	1	24	2+1	
		Shërbime		Udheheqes i udhetimeve dhe grupeve turistike	1	24	2+1
				Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	24	2+1
				Asistent në organizimin e ngjarjeve (Evenimenteve)	1	24	2+1
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit		Teknik i informatikës së biznesit	1	24	2+1
Gjithsej - QK - Prizren				8	192		

Vendi	Shkolla	Drejtimit	Profilet	Paralelet	Nr.Nxënë sve	Vitet	
Malishevë	Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi"	Ekonomi, Administrim dhe juridik	Asistent i Administratës	1	15	2+1	
			Banka dhe sigurime	1	4	2+1	
			Marketing	1	17		
			Shpedicion dhe logjistikë	1	09		
		Shërbime		Asistent hotelier	1	13	
		Teknologji e informacionit dhe komunikimit					
Makineri, prodhim dhe ndertimtari		Instalues elektrik	1	4	2+1		
Art					2+1		
Gjithsej- QK – "Kujtim Krasniqi" Malishevë				6	62		



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

